



K.DH.SH.II.nr.9/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Ada Group” Sh.A. me seli në rr.”Ahmet Krasniqi” bl. C2-10, obj. B.h.1, NR.4/1, Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Sogojeva, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.92/22 të datës 17.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar me seli në Prishtinë e datës 10.11.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.92/22 të datës 17.07.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar KA.nr.92/22 të datës 17.07.2023, në pikën I. të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Ada Group” Sh.A, ka anuluar si të kundërligjshëm vendimin nr.62/2019 të datës 26.02.2018 me vendimin e Komisionit për Hetim dhe Disiplinë nr. 332/17 i datës 26.12.2017 të nxjerrë nga i padituri Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. Nën pikën II. Ka vendosur, ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues, nën pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i të paditurit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aprovohet si e themeltë ankesa e të paditurës Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar në Prishtinë, të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e pa themeltë dhe të mbeten në fuqi vendimet e të paditurës nr.62/2019 i datës 26.02.2018 dhe vendimi i Komisionit për Hetim dhe Disiplinë nr.332/17 i datës 26.12.2017.

Përfaqësuesi i paditësit me datë 20.12.2023 ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën ei kundërshton pretendimet e të paditurës të pretenduara në ankesë të paraqitura ndaj aktgjykimit me nr. KA.nr.92/22 të datës 17.07.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e të paditurës Këshilli i Kosovës për

Raportim Financiar-KKRF dhe të vërtetohet Aktgjykimi me numër KA.nr.92/22 i datës 17.07.2023 i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative.

Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi ankesën e paditësit, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative, (LKA), dhe neni 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm si në vështrim të nenit 63 të LKA, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se organi i paditur, Komisioni për Hetim dhe Disiplinë me vendimin 332/2017 të datës 26.12.2017 ka shpallur përgjegjëse “Ada Group” ShPK nga Prishtina, pasi që në afatin e paraparë ligjor nuk i ka dorëzuar pasqyrat financiare të audituara pranë KKRF-së. Ndërsa Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar me vendimin KKRF.nr.62/2018 të datës 26.02.2018 ka refuzuar ankesën e palës “Ada Group” ShPK nga Prishtina e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Hetim dhe Disiplinë nr.26.01.2018 si e pa bazuar dhe ka konfirmuar Vendimin e Komisionit për Hetim dhe Disiplinë nr.332/2017 të datës 26.12.2017.

I pakënaqur me vendimin e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar nr.62/2018 të datës 26.02.2018, paditësi me padi inicion konflikt administrativ në Gjykatë me datë 14.03.2018. Dhoma e Shkallës së Parë në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se; gjykata ka vlerësuar se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri në procedurë administrative ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për çfarë ka sjellë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht dhe nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. gjykata ka konstatuar se paditësi gjatë vitit 2016 ka pasur qarkullim vjetor në vlerë prej 2,363,235.00€, ka poseduar asete në vlerë prej 1,697,243.00€ dhe ka pasur të punësuar mesatarisht 41 persona, ashtu që nuk e ka plotësuar asnjërin nga kriteret për tu klasifikuar si shoqëri tregtare e madhe si dhe e obliguar për të raportuar pranë KKRF, andaj gjykata ka vlerësuar se i padituri gabimisht e ka klasifikuar paditësin si shoqëri tregtare në kuptim të nenit 4 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, rrjedhimisht edhe gjoba e shqiptuar sipas nenit 23par.3 të këtij ligji është e kundërligjshme. Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka plotësuar kriteret e nenit 4 par.1 të Ligjit për Kontabilitet , Raportim Financiar dhe Auditim për tu klasifikuar si shoqëri tregtare e madhe pasi që nuk ka plotësuar dy nga kriteret në vijim: a) qarkullim vjetor (neto) më i madh se katër milion (4000000) Euro; b) asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: më të mëdha se dy milion euro (2000000) Euro; dhe c) numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 50. Gjukata ka konstatuar se neni 11 i Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim ka përcaktuar obligimin për raportim pranë KKRF-së vetëm për shoqëritë e mëdha kjo në përputhje me nenin 5 par.1 të këtij ligji i cili përcakton standardet që shoqëritë e mëdha duhet të aplikojnë gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Po ashtu gjobat e përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji mund të shqiptohen në rastet kur shoqëritë nuk i dorëzojnë pasqyrat financiare në kuptim të nenit 11, pra shoqëritë të cilat klasifikohen si shoqëri tregtare të mëdha. Gjukata ka vlerësuar se i padituri ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike që ka rezultuar në zbatim të gabuar të së drejtës materiale kur fillimisht paditësin e ja klasifikuar si shoqëri tregtare të mëdha dhe me vendimin nr.332/2017 të datës 26.12.2017 ka konstatuar se ka bërë

shkelje të nenit 11 lidhur me nenin 23 par.3 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për çfarë ka shqiptuar gjobën në shumë prej 10,000€, e pastaj edhe shkalla e dytë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale dhe me vendimin me nr.62/2019 të datës 26.02.2018 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar në tërësi vendimin e Komisionit për Hetim dhe Disiplinë pranë KKRF. Gjykata ka vlerësuar se vendimet kontestuese me nr. 62/2019 i datës 26.02.2018 dhe vendimi nr.332/17 i datës 26.12.2017, janë në kundërshtim me nenin 4 par.1 dhe nenin 11 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, rrjedhimisht edhe gjoba e shqiptuar është në kundërshtim me nenin 23 par.3 të Këtij ligji, prandaj në kuptim të nenit 46 par.3 të LKA-së vendosi si ën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që anuloi vendimet kontestuese.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke shqyrtuar aktgjykimin e Dhomës së Shkallës së Parë në bazë të ankesës së paditësit dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë a aktit përfundimtar administrativ në bazë të padisë, përgjigjes në padi provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe shkresave të tjera të lëndës si në vështrim të nenit 41 dhe 44 të LKA, dhe drejtë e ka vendosur çështjen me refuzimin e kërkesë padisë së paditësit. Organi i paditur është dashtë që pas shqyrtimit të ankesës së paditësit të nxjerr aktvendim përmbajtjesor, ashtu si parashihet me nenet 84, 85 dhe 86 të LPA-së, i cili aktvendim do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjet faktike, bazën ligjore në të cilat bazohet akti, po ashtu nuk ka zhvilluar as edhe procedurën e administrimit të provave, në arsyetim mbi bazën e të cilave kish mundur të arsyetoj pretendimet e ankesës se provat e administruara nga Dhoma e Shkallës së parë janë vlerësuar me aplikim të gabuar të dispozitave ligjore dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se i padituri ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike nga ka rezultuar edhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale përkatësisht nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, pasi që ky ligj ka përcaktuar qartë kategoritë e shoqërive tregtare për qëllim të raportimit financiar dhe si shoqëri të mëdha i ka klasifikuar ato shoqëri të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim a) qarkullim vjetor (neto) më i madh se katër milion (4000000) Euro; b) asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: më të mëdha se dy milion euro (2000000) Euro; dhe c) numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 50.

Kolegji duke i shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet ankimore të paditurës të cilat konsistojnë në bazat e theksuara si më lartë, vlerëson se pretendimet e theksuara janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara, sepse nuk dëshmohet Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës. Kolegji duke shqyrtuar çështjen edhe sipas detyrës zyrtare gjen se gjendja faktike nga Dhoma e Shkallës së Parë është vërtetuar në mënyrë të plotë gjatë administrimit të provave në seancë të shqyrtimit kryesor, nga është vërtetuar se pretendimet e të paditurit janë të pabazuara dhe në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar faktike në organin e paditur dhe provave të cilat janë në shkresat e lëndës, nga këto fakte është vërtetuar se aktgjykimi i ankimuar është në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.08/L-015 të Gjykatës Komerciale dhe nenit 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë gjendje të fakteve të provuara kolegji konstaton se çështja në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të organit administrativ përfundimtar është shqyrtuar në mënyrë të argumentuar në baza ligjore, andaj pretendimet ankimore kolegji i vlerësoi si të pa ndikim për tu vërtetuar gjendje tjetër faktike, dhe për të vendosur ndryshe nga ajo që është vendosur në Dhomën e Shkallës së Parë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.9/24, me datë 24.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami